

Mbi Tipologjitë e Trashëgimisë në Qytetin e Elbasanit

Received: 03.03.2025 / Accepted: 22.03.2025 / Published: 16.04.2025

© 2024 Zhuljeta DAJA

Doi: <https://doi.org/10.5281/zenodo.15229070>

Abstrakt

Jeta dhe përparimi i çdo shoqërie njerëzore mbështetet fort në arritjet dhe kulturën e shoqërive dhe brezave paraardhës. Kjo është e vërtetë edhe për shoqërinë tonë bashkëkohore. Në mjedisin që na rrethon, ruhen elemente të ndryshme dhe të shumta të trashëguara deri tek ne nga shoqëritë dhe brezat para nesh. Trashëgimia kulturore është një realitet dinamik, historik, sepse është një tërësi e hapur dhe jo e mbyllur dhe si e tillë jo definitive, por gjithnjë në zgjerim, sepse ajo vijon të jetë pjesë e gjetjeve të vazhdueshme në fusha të ndryshme. Trashëgimia kulturore e shek. XX, apo “Trashëgimia Moderne” është një koncept i ri në sistemin e trashëgimisë kulturore shqiptare e më gjerë. Në se bëjmë një vlerësim të qytetit të Elbasanit (Elbasani si objekt studimi) gjatë periudhave të ndryshme historike vemë re ndryshime të mëdha sidomos në arkitekturë, mënyrën e jetesës, industrializim, urbanistikë, zhvillim ekonomik etj. Në Elbasan kemi dy tipologji të trashëgimisë. Elbasani është mjaft i pasur me objekte të trashëgimisë kulturore, por ka edhe prani të objekteve të periudhës komuniste. Kjo trashëgimi e krijuar veçanërisht gjatë kësaj periudhe mbart elementë të sistemit ekonomik e politik kur u krijua. Në tërësi ajo tregon jetën reale të qytetit në sistemin komunist. Për të shkruar këtë artikull kemi shfrytëzuar dokumente arkivore, literaturë historiografike dhe gjithashtu janë evidentuar në terren të objekte të kësaj periudhe. Në përfundim mund të pohojmë se tipologjia e trashëgimisë shpreh në të gjithë dimensionet periudhën së cilës i përket. Zhvillimi i shoqërisë, në cilëndo etapë, ka formuar një trashëgimi të pasur kulturore dhe të shumëllojshme. Kjo trashëgimi e pasur dhe me cilësi shumë të ndryshme duhet vlerësuar, studiuar dhe pse jo duhet të kthehet në impakt për zhvillimin e turizmit. Gjithashtu edhe veprat e krijuara sot, por që kanë vlerë arkitekturore duhet të jenë pjesë e trashëgimisë dhe të vlerësohen. I tillë është rasti i xhamisë së Ballies, që fitoi çmimin si objekti i kultit më i mirë në botë për vitin 2025.

¹ Lektore Kolegji Universitar “Beder”, Email: zhkadilli@yahoo.com

Fjalë kyçe: Elbasan, arkitekturë, periudhë historike, trashëgimi kulturore, trashëgimi moderne

Hyrje

Trashëgimia kulturore është një nga pasuritë e çmuara të krijuara nga njeriu. Jeta dhe përparimi i çdo shoqërie njerëzore mbështetet fort në arritjet dhe kulturën e shoqërive dhe të brezave paraardhës. Kjo është e vërtetë edhe për shoqërinë tonë bashkëkohore. Në mjedisin që na rrethon ruhen elemente të ndryshme dhe të shumta të trashëguara deri tek ne, nga shoqëritë dhe brezat para nesh. Aftësia krijuese e shoqërisë së kaluar ka lënë gjurmë të prekshme (lëndore) që i ndeshim në formën e mbetjeve arkitekturore që gjenden përreth nesh, ashtu edhe në formën e strukturave arkeologjike nën sipërfaqen e tokës, në formën e objekteve të përdorimit të përditshëm, në formën e objekteve apo të veprave të artit; në formën e botimeve apo objekteve që vijnë si rrjedhojë e veprimtarisë krijuese letrare, shkencore e artistike. Çdo objekt i prodhuar përmban në vetvete një informacion të pasur historik dhe kulturor për ato shoqëri dhe brezat që e kanë krijuar. Si të tilla, këto objekte, përfaqësojnë pjesë të trashëgimisë sonë historike. Gjithsesi, kjo duhet parë dhe vlerësuar edhe brënda përmbajtjes së vlerave më së shumti, përveç aspektit kohor.

Koncepti i Trashëgimisë kulturore ka ndryshuar me kalimin e kohës në aspektin e konceptit kohor. Në se më parë legjislacioni kombëtar apo dhe ai i huaj e konceptonte trashëgiminë në kufijtë kohorë jo më pak se 100 vjet² për objektet e vëna në mbrojtje si monumente kulture, sot ka një tjetër vlerësim, jo vetëm në konceptin kohor, por edhe në përmbajtje. Trashëgimia Kulturore është trajtuar si koncept ku përfshihet midis të tjerave koha e realizimit të objekteve dhe në këtë drejtim janë bërë përparime të mëdha. Konkretisht, në drejtim të vënies në mbrojtje të disa objekteve që në fakt nuk janë 100 apo më shumë se 100 vjeçare. Shoqëria shqiptare ka filluar të sensibilizohet ndaj këtij problemi, sidomos tani që ka filluar të prishen objekte të vjetra, që ndoshta mund të mos jenë 100 apo mbi 100 vjet. Këto objekte që i përkasin shekullit të kaluar bëjnë pjesë në atë që quhet “Trashëgimi Moderne”³. Periudha e shkurtër që ka kaluar e vështirëson pak problemin e njohjes dhe trajtimit të këtyre objekteve. Në këtë kontekst, gjykimi i

² Legjislacioni për Trashëgiminë Kulturore, Nr.9048, datë 7.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore” i azhurnuar, Ministria e Kulturës dhe Sporteve Drejtoria e Zhvillimit të Turizmit dhe Kulturës Kombëtare, Sektori i Kulturës Kombëtare, Neni 4, pika 1.a.

³ Lorenc Bejko, Trashëgimia Moderne, leksione për studentët e nivelit master Shkencor në Trashëgimi Kulturore, Tiranë 2017, f. 1.

kësaj trashëgimie duket si gjykim i vetvetes. Nëse do të nisemi nga vlerësimi i “Trashëgimisë Moderne” do të na duket sikur vlerësojmë vetveten dhe kjo sigurisht është e vështirë. Të gjitha trashëgimitë nga më e vjetra tek më e reja ajo moderne, ka në vetvete një dëshmi historike, i përket një periudhe të caktuar historike. Por konteksti historik i Trashëgimisë Moderne është shumë i ndryshëm. Ai ka në thelb modernizimin e vrullshëm të shoqërisë njerëzore që është karakterizuar nga shumë studiues të filozofisë dhe sociologjisë si një tërësi procesesh të formimit të kapitalit dhe mobilizimit të burimeve, të zhvillimit të forcave prodhuese dhe rritjes së rendimentit të punës, të konsolidimit të pushtetit politik të centralizuar dhe formimit të idenditeteve kombëtare, të përpunimit të të drejtave të pjesëmarrjes politike dhe të formave urbane të jetesës, të edukimit formal dhe të sekularizimit të vlerave e normave etj. Pra, në qendër të modernizimit nuk qëndron vetëm koncepti teknologjik, por edhe ai i individualizimit të shoqërisë, demokratizimit dhe industrializimit të saj⁴.

Një qasje moderne nuk nënkupton jo vetëm mbrojtje të trashëgimisë kulturore, por të çon në dëshira më të madh të këtij procesi. Kjo qasje tregoi se përdorimi me kujdes i objekteve historike (ndërtesat, zonat) është më e favorshme për rivitalizimin ("kthimi në jetë") e trashëgimisë kulturore se sa të përqëndrohet vetëm në sigurinë. Monumente të trashëgimisë kulturore janë bërë jo vetëm një kujtesë e së kaluarës, para së gjithash, ato janë bërë të rëndësishme si një vlerë në sytë e bashkëkohësve. Ato janë të mbushur me kuptime të reja.

1. Metodologjia

Për të shkruar artikullin jemi mbështetur në një metodologji shkencore, e cila konsiston në vlerësimin e literaturës të parë në këndvështrimin kritik dhe krahasues. Veç kësaj kemi shfrytëzuar dokumente arkivore dhe me verifikimin në teren të objekteve të trashëgimisë. E veçanta është se tipologjitë e trashëgimisë i vlerësojmë, jo vetëm në përmbajtje, por edhe në aspektin e impaktit për zhvillimin e turizmit dhe promovimin e qytetit. Vënd me rëndësi ka trashëgimia moderne si koncept i ri në terminologjinë e trashëgimisë dhe domosdoshmëria e identifikimit të saj.

2. Periudhat e para të krijimit të trashëgimisë kulturore historike

⁴Po aty.

Gjatë shekujve në këtë mjedis ekonomik u krijua edhe një psikologji që kultivohej drejt punës, përparimit dhe lulëzimit të gjithanshëm. Puna, duart dhe mendja e njeriut krijuan thesare dhe tradita në fushën e kulturës dhe artit. Dëshmi të kësaj tradite të përvijuar ndër shekuj janë kontributet e piktorëve të mëdhenj Onufri, David Shpataraku, ndërtimet në fushën urbanistike, produktet e zejtarisë etj.

Një nga objektet me vlera të rralla historike dhe kulturore është kalaja. Kalaja është objekti simbol i qytetit të Elbasanit. Për herë të parë përmendet nga Ptolemeu në shek. II të erës sonë, si stacion i rrugës Egnatia e më pas si vend fushimi i legjioneve romake⁵. Më 1466 Sulltani e rindërtoi kalanë dhe më pas u bë fillesa e qytetit të Elbasanit. Nga qendër për vendosjen e ushtarëve, gradualisht filloi të popullohej me banorë të ardhur dhe vendas. Rindërtimi i kalasë së Elbasanit, kishte rëndësi të madhe strategjike për turqit, pasi ndodhej në mes të Shqipërisë, mbi rrugën ushtarake tregtare që kalonte nëpër luginën e Shkumbinit, Via Egnatia.⁶ Kalaja e Elbasanit përmban në perimetrin e mureve të saj rrethues një histori tepër komplekse. Aty gjejmë te mbivendosur muret e ndërtimeve romane, byzantine, osmane dhe së fundmi bashkëkohore. Veçanërisht pas Shpalljes së Pavarësisë, kalaja paraprin ndryshimin brenda saj, por edhe në mendësinë e njerëzve në Elbasan.

Brënda mureve të kalasë është kisha e “Shën Marisë” e cila ka qenë egzistuese që në vitin 1661 dhe është rindërtuar në vitet 1826-1823 pas një zjarri të rënë në vitin 1818. Ajo përbën një shëmbull të veçantë në studimin e arkitekturës postbizantine. Përveç kishës, në kala ndodhet edhe xhamia “Mbret” që është më e madhja dhe e vjetra faltore e qytetit, në qendër të kalasë, në të djathtë të rrugës, nga hyrja e portës për në qendër. Ajo i përket vitit 1492 dhe ka interes të veçantë, pasi ruan format e dikurshme. Xhamia e “Nazireshës” mendohet se i përket vitit 1599, ndodhet në jug të qytetit të Elbasanit dhe paraqet mjaft interes për aspektin arkitekturor, që lidhet me tendencën për të rritur lartësinë në hedhjen e saj vertikale⁷.

Pjesë e traditës së kulturës osmane janë edhe hamamet. Në Elbasan në shek. XIX dhe në fillim të shek XX ka pasur tre hamame⁸. Hamami i Vjetër ndodhej brenda kalasë, Hamami i

⁵Ylli Cerova, *Castrum Skampis*, ILIRIA, Revistë Arkeologjike, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Instituti i Arkeologjisë, Tiranë 1997, Nr.1, f. 285

⁶ Gj.Karaiskaj, *5000 vjet fortifikime në Shqipëri*, Shtëpia Botuese “8 Nëntori”, Tiranë 1981, f. 206.

⁷ A.Meksi, *Arkitektura e Xhamive të Shqipërisë shekujt XV-XIX*, Shtëpia Botuese “UEGEN”, Tiranë, 2007, f. 57.

⁸ AQSh, F. nr 113/1, dosja 3-19.

Shabanajt në pjesë qëndrore të tregut, si dhe Hamami i lagjes “Haznedare”. Këto hamame vlerësohen për anën ndërtimore dhe arkitektonike e cila është tipike otomane⁹.

Vlera të veçanta kulturore u krijuan edhe në punimet zejtare të cilat kanë qenë të përmëndura jo vetëm në Shqipëri, Ballkan por dhe më gjerë. Zhvillimi i zejtarisë në shek. XVII e në vazhdim, lidhet edhe me faktin që ai ndodhej në një pikë të rëndësishme të rrugës tregtare Egnatia. “Rolin kryesor në jetën ekonomike të qytetit e luante pazari me njësitë e veta të prodhimit dhe shkëmbimit”¹⁰. Të gjitha produktet e dala nga duart e zejtarëve elbasanas dallonin për cilësinë e tyre.

Zeja e gëzoftarëve numëronte 51 dyqane¹¹. Në dokumentet e kohës thuhet se lëkurët e dhelprës, shqarrit, kunadhes, qengjave të qumshtit, të qafës së rosave të egra, ishin material i rëndësishëm eksporti. Këto materiale njëherazi përdoreshin për veshjen dhe zbukurimin nga brënda dhe jashtë të rrobave verore e dimërore për shtresat e pasura qytetare dhe për aristokracinë e lartë feudale si dhe kërkoheshin në tregjet e huaja¹².

Një rëndësi të veçantë gjatë shek. XIX mori zejtaria e argjendarisë, u rrit dhe u zgjerua prodhimi i sendeve artistike. Këto prodhime ishin mjaft cilësore e pëlqeheshin nga vendasit dhe të huajt. Për gratë prodhoheshin byzylykë, unaza, karfica, vathë, gjerdanë, etj. Për burrat argjendarët prodhonin: qostekë, zinxhirë dekorativë, zbukurime armësh etj. Një vënd të veçantë zinin objektet artistike të përdorimit të gjërë si: shandanët, kandilët, gotat, lugët, pirunjtë, etj. Në këtë periudhë në Elbasan kishte 64¹³ dyqane argjendarie. Zeja e vjetër e kazazëve (mëndafshpunuesve) ka qenë mjaft e përmëndur. Në fillim të shek. XX Elbasani prodhonte përveç tekstileve të holla edhe shami paje për nuset që ishin me zë në të gjithë Rumelinë¹⁴. Në lidhje me zhvillimin e kësaj “industrie”, gazeta lokale “Shkumbini”, e vitit 1921 shkruante se: “Para Luftës së Parë Botërore, artzanati, zejtaria shtëpiake e prodhimit të pëlhurave të pambukta dhe të mëndafshita nëpërmjet avlëmendit, ishte një zanat, ku pothuajse në çdo shtëpi të

⁹ Po aty.

¹⁰ V.Duka, *Qytetet e Shqipërisë 1912-1924*, Shtëpia Botuese “Toena”, Tiranë 1997, f. 11.

¹¹ A.Q.Sh, F.nr, 113/1, dosja 3-19.

¹² Z.Shkodra, *Esnafet Shqiptare*, shek.XV-XX, Akademia e Shkencave e R.P.Shqipërisë, Tiranë 1973, f.184.

¹³ A.Q.Sh, F.nr, 113/1, dosja 3-19.

¹⁴ Z.Shkodra, *Esnafet.....*, vep e cit, f. 128.

Shqipërisë së Mesme punonin gratë. Pëlhurat e prodhuara në Elbasan, ishin me nam në të gjithë Toskërinë e Maqedononë”¹⁵.

Për Elbasanin nuk do të lemë pa përmendur edhe zejen e prodhimit të biçakëve ose brisqeve siç quhen ndryshe. Zeja e prodhimit të biçakëve ishte e zhvilluar. Punishtet ishin vendosur prapa Portës së Kalasë. Produktet ishin me një cilësi të lartë artistike. Cilësia dhe bukuria e tyre i bënte të mjaft të pëlqyera edhe në tregjet e huaja. Madje në bisedat e kohës për mallrat e këtij lloji thuhej: do të jap peshqesh dhe një biçak prej Elbasani¹⁶.

E njohur në qytetin ishte edhe zeja e terzinjve (rrobaqepësve). Kjo zeje, ka qenë mjaft e hershme, mendohet se kodiku i testirimit të tij i përket vitit 1727. Terzinjtë e talentuar elbasanas punonin kostumet e burrave dhe të grave, që shquheshin për stilin e veçantë shqiptar. Kjo zeje artistike e punës me dorë shkëlqeu për dy shekuj, e vetëm në fillim të shek. XX, pësoi rënie. Pa dyshim që pjesë e kësaj trashëgimie është edhe guzhina tradicionale e qytetit. Elbasani është përmendur për gatime, që nga simitja me bugaçe, tava e kosit, ballokumet, etj të cilat, janë të njohura jo vetëm në Shqipëri por edhe më gjerë. Në përgjithësi, këto janë disa nga elementet e trashëgimisë kulturore në Elbasan, të krijuara në shekuj, pa përmendur aspekte të jetës shpirtërore të cilat nuk mungojnë. Jeta njerëzore në zhvillimin e saj, shfaqet si një rrjedhë e vetme, e cila përgjithësisht shkon drejt bashkë-përfshirjes së shoqërisë. Kështu qartazi kuptohet, se e tashmja dhe e kaluara shfaqen veçse si faza ecurie të një bashkësie të vetme, shoqërisë njerëzore. Prandaj studimi i historisë i kalon natyrshëm kufijtë e një kureshtjeje, për t’u kthyer në një fushë të rëndësishme të dijes, e cila qartëson të kaluarën në dobi të së tashmes dhe të ardhmes.

Eshtë në natyrën e qënies njerëzore kjo rrekje drejt zotërimit të realiteteve dhe dukurive me shfaqje të veçanta kohore hapësinore. Eshtë i natyrshëm ky moment, që është konkret në materializimin e tij tek një individ apo individë dhe përgjithësues, kur karakterizon në tërësi një grup njerëzish, një popull, një komb. Në këtë çast qëndrimet, natyrshëm mund të priren ndaj vështrimit, hulumtimit dhe vlerësimit të traditës. Tradita, “Me këtë fjalë, kam parasysh gjithë kompleksin e zakoneve, institucioneve, miteve dhe besimeve të respektuara nga koha që krijohen në një shoqëri në dhjetvjeçarë e shekuj të tërë radhazi”, vëren Glen Tinder. Më tej ai

¹⁵ Gazeta Shkumbini, viti 1923.

¹⁶ Sh.Demiri, *Histori e shkurtër e trevës së Elbasanit*, Egnatia, Tiranë 2007, f. 46.

vazhdon: "Shumë njerëz të mënçur kanë qënë të mendimit se tradita është pasuria më e çmuar e një shoqërie. Ajo përcakton kushtin bazë të egzistencës njerëzore"¹⁷. Faktorët që lidhen me këtë si: evidentimi i vlerave historike, mirëmbajtja, restaurimi, promovimi dhe komunikimi i këtyre vlerave, nxisin lëvizjet e njerëzve për t'i njohur këto vlera. Pikërisht në këtë kontekst problemi më i rëndësishëm krahas identifikimit dhe rivializimit të objekteve të trashëgimisë, është komunikimi i vlerave. Institucionet që kanë për detyrë promovimin e këtyre vlerave dhe të turizmit në përgjithësi duhet të dinë se çështje komunikimi i vlerave dhe cilët janë mjetet dhe mënyrat për ta bërë atë.

3. Trashëgimia kulturore historike e krijuar në fillimet e shek. XX

Dy periudha kryesore në zhvillimin urban të Elbasanit mbizotëruan gjatë shekullit të 20-të. Në fakt nuk pati ndryshime të dukshme në zhvillimin urban gjatë viteve 1912-1924, menjëherë pas shpalljes së Pavarësisë. Periudha e parë e rëndësishme fillon gjatë viteve 1924-1939, me ndryshime të mëdha politike dhe ndryshime, si krijimi i Republikës së Shqipërisë në 1925 dhe krijimi i Mbretërisë Shqiptare më 1928. Marrëdhëniet politike dhe ekonomike me Italinë u forcuan. Këto lidhje të ngushta u pasqyruan në marrëveshjet e partneritetit të nënshkruara mes Tiranës dhe Romës. Në atë periudhë, familjet e biznesit dhe artizanatit në Elbasan filluan të investonin për kushte më të mira jetese si dhe për arsimimin e fëmijëve të tyre në vendet e Evropës Perëndimore. Shembuj të këtyre familjeve janë Dakli, Biçaku, Daiu, Hostopalli, Deljana, Buda etj. Të rinjtë e arsimuar perëndimor të këtyre familjeve sollën në Elbasan një mentalitet të ri dhe u orientuan drejt një mënyre të re jetese. Italia në veçanti pati një ndikim më të madh në këtë proces dhe gjithashtu luajti një rol të rëndësishëm për t'i dhënë qytetit një pamje moderne. Ky ndikim italian u reflektua më së shumti në projektimin urban të Elbasanit dhe territoreve përreth tij, të cilat u morën nga plani infrastrukturor i Shqipërisë i hartuar në fund të viteve 1920. Një shembull i këtij ndikimi është ndërtesa e Bashkisë (sot godina e Prefekturës), e cila është ndërtuar në vitin 1926, biblioteka kryesore publike e qytetit, shkolla "Ali Agjahu", ndërtesa e Bankës Tregtare, godina e kinemasë, sot teatri Skampa etj.

Përveç këtyre ndërtesave, shtëpitë e disa familjeve të pasura u ndërtuan në stilin evropian. Shembuj janë shtëpia e familjes "Biçaku" në lagjen Karaveli afër murit të Kalasë, shtëpia e Lef Nosit brenda në Kala, shtëpia e familjes Plangarica, në lagjen Beqire (sot quhet lagja Qemal

¹⁷ G.Tinder, *Mendimi Politik*, Tiranë 1993, f. 153.

Stafa), shtëpia. të familjes Hostopalli në lagjen Bobolle, shtëpia e familjes Vërlaci etj. Këto shtëpi ndiqnin stilin evropian jo vetëm në pamjen e jashtme por edhe në arredimin e brendshëm. Në këtë kontekst të stilit të ri gjejmë edhe një ide mbizotëruese për krijimin e qendrave politike, kulturore dhe rezidenciale. Të gjitha kriteret e mësipërme u pasqyruan në urbanistikën e hartuar nga italianët (1940)¹⁸.

Në vitet '40 të shek. XX u hartuan rregullore, të cilat shërbyen si një përpjekje për një ligj të zhvillimit urban. Përpjekjet për hartimin e këtij ligji synonin të përqendronin të gjitha veprimtaritë urbane në duart e pushtuesve, të cilat pasqyronin politikat fashiste në Shqipëri¹⁹. Për të mbikëqyrur zhvillimet urbane në Shqipëri, Italia krijoi një zyrë qendrore për zhvillimin urban. Detyra e kësaj zyre nuk ishte vetëm projektimi i ndërtimit, por edhe planifikimi financiar. Kjo zyrë ishte shumë aktive gjatë kësaj kohe për shkak të diskutimeve për vendosjen e standardeve dhe rregullave urbane si dhe për ruajtjen e monumenteve historike dhe mjedisit²⁰.

Plani urbanistik i Elbasanit u miratua në vitin 1940²¹ dhe bazohej në planin e vitit 1927. Objektivat kryesore të këtij plani ishin shfrytëzimi i burimeve në territoret dhe ndërhyrjet në qendër të qytetit. Një tjetër element i rëndësishëm ishte ndërtimi i objekteve jashtë Kalasë dhe krijimi i parqeve të gjelbra, të cilat mundësonin pamjen e vlerave monumentale të Kalasë. Ky plan konsideronte edhe qendrën politike dhe administrative të qytetit pranë godinës së Bashkisë (1926).

Në kuadrin e perspektivës së zhvillimit nën ndikimin italian, turizmi dhe zejtaria morën një rëndësi të veçantë në planin urbanistik të vitit 1942. Ky plan konsideronte si jetike ndërhyrjen në disa burime të mundshme si turizmi dhe ruajtjen e disa objekteve të periudhës osmane²². Është e qartë se pushtuesit italianë u përpoqën të ruanin atë që trashëguam nga e kaluara dhe në të njëjtën kohë të sillnin një perspektivë të re nga qytetet evropiane. Gjatë kësaj kohe objektet e kultit islam dhe ortodoks u ruajtën së bashku me disa ndërtesa të rëndësishme si: shtëpia e familjes Sejдини, shtëpia e Aqif Pashës, banjat turke etj., që paraqisnin vlera historike dhe arkitekturore.

Pas çlirimit të vendit në vitin 1944, Partia Komuniste e drejtoi Shqipërinë drejt një ekonomie të centralizuar dhe modeli sovjetik. Të vendosur të transformonin me çdo çmim vendin

¹⁸ Maria Adriana Giusti, *Albania, Architettura e Citta (1925-1943)*, Albania, Architecture and City, Maschinetto Publisher (Firenze, 2006), 76.

¹⁹ AQSH, Fondi i Ministrisë së Ndërtimit, Nr. 899, Dosja nr. 894, f. 4.

²⁰ Giusti, f. 37.

²¹ Giusti, f. 39-42.

²² Giusti, f. 77.

komunistët shqiptarë përqaftuan me zell ndryshimin rrënjësor të komanduar nga lart dhe disiplinimin e shoqërisë. Nën drejtimin e tyre, struktura e pushtetit shtetëror e mori në duart e saj detyrën e misionit civilizues dhe modernizimit të Shqipërisë.

Ky stil vazhdoi deri në fillim të viteve 1960, që shënoi ndërprerjen e marrëdhënieve diplomatike me Bashkimin Sovjetik²³. Teoritë marksiste ishin orientimi kryesor i zhvillimit të vendit. Enver Hoxha, diktatori komunist që udhëhoqi vendin për 40 vjet, urdhëroi shpronësimin e pronarëve pa shpërblim dhe vendosi pronësinë kolektive. Planet e kësaj periudhe u hartuan pa marrë parasysh nevojat e popullsisë. Edhe në fushën e zhvillimit urban Partia Komuniste shkatërroi gjithçka që i përkiste së shkuarës. Gjatë viteve të para pas Luftës së Dytë Botërore, plani i qytetit u kërkua të bazohej në parimet e ekonomisë socialiste, duke ndjekur kështu përvojën sovjetike. U krijua një komision publik ndërtimi që përfshinte specialistë shqiptarë dhe të Bashkimit Sovjetik. Stili i ri në zhvillimin urban të kësaj periudhe përfshinte ndërtimin e apartamenteve tepër të vogla, 29-50 metra katrorë dhe ndalimin e ndërtimit të objekteve private²⁴.

Në vitin 1960, Instituti shqiptar i “Zhvillimit Urban” paraqiti planin e parë urbanistik për Elbasanin, i cili duhej të zbatohej brenda 20 viteve. Ky plan ishte pjesë e planit rregullues për të gjithë Shqipërinë. Planin synonte të linte pas të shkuarën dhe të rindërtonte dy rrugët: “28 Nëntori” dhe “Qemal Stafa”. Përgjatë këtyre dy rrugëve objektet private u shpronësuan dhe më pas u prishën. Në vend të tyre, numri i madh i ndërtesave të banimit që u ndërtuan në të dy anët e rrugëve i dhanë një pamje të re qytetit, në të cilin mbizotëronte uniformiteti dhe stili kolektiv i jetesës. Stili italian i katrorit u zëvendësua nga dy rrugë paralele. Sot, këto ndërtesa të periudhës 1960-1970, ekzistojnë ende dhe janë simbol i regjimit komunist në vendin tonë. Feja ishte e ndaluar pasi konsiderohej si shkaktar i prapambetjes sociale. Të gjitha objektet fetare u shndërruan në qendra kulturore dhe sportive.

Njëkohësisht këto objekte fetare u zëvendësuan me monumente të heronjve të Luftës Nacionalçlirimtare në Shqipëri apo personaliteteve të dalluara të zonave të ndryshme. Konkretisht, xhamia e lagjes “Karaveli” u shkatërrua dhe në vend të saj u vendos monumenti i dy heronjve Abdyl dhe Haxhire Myzyri, xhamia e “Tabakes” u zëvendësua me monumentin e Kostandin Kristoforidhit, i cili ishte një gjuhëtar i rëndësishëm i Rilindjes Kombëtare Shqiptare.

²³ Nina Smirnova, “*Historia e Shqipërisë përgjatë shekullit XX*”, Botimet (IDEART, 2004), f. 377.

²⁴ AQSH, Fondi i Ministrisë së Ndërtimit, Nr. 899, Dosja nr. 894, f. 4.

Partia e Punës vendosi gjithashtu të zëvendësojë festat fetare, si Krishtlindjet, Pashkët apo Bajrami, me festime kombëtare, lokale dhe të njohura sipas modelit socialist. Madje Partia sugjeroi që këto festa të reja (socialiste) të ishin të mëdha dhe të bukura për të plotësuar vakumin e krijuar nga mungesa e atyre fetare dhe për të ndikuar në edukimin ideologjik të shoqërisë.

Kjo u konsiderua si masakra më e keqe në historinë urbane të qytetit. Në vend të tregut tradicional të periudhës osmane dhe italiane, u ngritën ndërtesa të reja, si hotel “Skampa”, qendra e brendshme sportive, një park etj. Në vitin 1970, si pjesë e zhvillimit urban dhe industrial, u ndërtua Kombinati Metalurgjik, në luginën e lumit Shkumbin, me ndihmën e Republikës së Kinës. Ky ndërtim u konsiderua si pjesë e procesit të industrializimit dhe forcimit ekonomik të vendit. Qindra punëtorë dhe specialistë të ardhur nga qytete të tjera të Shqipërisë si dhe nga Kina kishin nevojë për strehim. Prandaj me punë vullnetare u ndërtuan apartamente të reja në pjesën veriore të qytetit dhe e gjithë zona u quajt lagjia “Vullnetari”. Në pjesën perëndimore të qytetit u ndërtuan hotele të reja për punonjësit shqiptarë, të cilët supozohej të jetonin përkohësisht në Elbasan. Në pjesën lindore të qytetit u ndërtua një kompleks i madh për punonjësit kinezë, të cilët punonin në fabrikën metalurgjike. Këto ndërtesa shkatërruan një pjesë të qytetit dhe nuk kanë asnjë vlerë arkitekturore, por kanë vlerë historike. Një numër i madh bunkerësh të ndërtuar në vendin tonë në vitet ’70 gjithashtu janë objekte të trashëgimisë moderne. Ato u ndërtuan në kohën e luftës së Ftohtë dhe në kushtet e një varfërie ekstreme të Shqipërisë.

Edhe plani rregullues i vitit 1983, i cili u miratua nga Instituti i Kërkimeve dhe Projekttimeve Urbane, bazohej në ekonominë e centralizuar dhe pronësinë shtetërore dhe paraqiste perspektivën urbanistike të qytetit për 20 vjet. Kjo periudhë u karakterizua nga një krizë e thellë ekonomike e cila ndikoi ndjeshëm në këtë plan si në sasi ashtu edhe në cilësinë e ndërtimeve.

4. Vlerësimi i trashëgimisë moderne

Trashëgimia kulturore e shek. XX, apo “Trashëgimia Moderne” është një koncept i ri në sistemin e trashëgimisë kulturore shqiptare e më gjerë. Në fakt pjesë e trashëgimisë kulturore ne kemi quajtur të gjitha ato objekte që kishin kaluar mbi 100 vjet. Por, tashmë nuk është vetëm ky përkufizim në kohë. Ka edhe objekte, të cilat nuk i përkasin këtij harku kohor, por që vendosen në mbrojtje, si objekte të Trashëgimisë Moderne. Këto objekte kanë cilësi të rëndësishme si në formë dhe në përmbajtje.

Trashëgimia Moderne ka një natyrë mjaft komplekse, sidomos në lidhje me me territorin dhe peisazhin. Në fakt, ka një dallim jo të vogël ndërmjet trashëgimisë së gjysmës së parë të shek. XX dhe gjysmës së dytë të tij. Duken si më të spikatura dhe estetike monumentet e gjysmës së parë të shek. XX. Kjo ndodh mbase edhe për shkak të qëndrimit emocional që kemi në përgjithësi ndaj periudhës së socializmit. Por duhet të jemi të ndërgjegjshëm edhe për investimin e madh dhe produktit historiko-kulturor të shoqërisë shqiptare gjatë gjysmës së dytë të shekullit të kaluar. Ne jetojmë në kontakt të vazhdueshëm me trashëgiminë moderne dhe tentojmë të mos e vlerësojmë objektivisht. Shumë gjëra jo vetëm që nuk na bëjnë përshtypje, por edhe nuk i shohim fare dhe nuk bëhemi merak kur ato zhduken apo degradojnë gradualisht. Kjo ndodh mendojmë se Trashëgimia Moderne mbart pak koncepte origjinale dhe në shumicën e saj përbëhet nga riprodhime të standartizuara të një forme. Për këtë arsye duhet të evidentohen ato që janë më specifike dhe që tregojnë një periudhë të caktuar historike. Konkretisht trashëgimia industriale, fabrika, Uzina, veçanërisht Kombinati Metalurgjik, rafineria e naftës në Cërrik, që janë veçanërisht tërheqës, janë pjesë e kësaj trashëgimie. Ansambli urban i ndërtuar sidomos në vitet 1950, 1980 lagjja e quajtur e kinezëve, kinemaja etj. Mbase këto nuk kanë vlera arkitektonike por janë tregues të një periudhe të caktuar historike. Veprat më të rëndësishme të periudhës Socialiste duhet të ruhen dhe të rijetëzohen. Ato kanë impakt sidomos tek brezi i ri që nuk e ka njohur atë kohë. Po kështu edhe bunkerët mbartin një histori mjaft interesante, por të domosdoshëm, madje edhe sot.

Ndonëse e ndërtuar sot, as më pak e as më shumë se 5 vjet më parë, xhamia e Ballies në Elbasan, është përzgjedhur si një nga 5 objektet më të bukura të kultit në botë dhe është nominuar për çmimin prestigjioz “Ndërtesa e Vitit 2025” nga "ArchDaily", një platformë online, shumë e njohur në fushën e arkitekturës. Ky vlerësim është një njohje e rëndësishme për arkitekturën bashkëkohore shqiptare, duke e vendosur Elbasanin në hartën globale të arkitekturës, sidomos me objektet e kultit. Lajmi nga ana tjetër ka rëndësi sepse, arkitekti që e projektoi është shqiptari Jurtin Hajro dhe kjo na bën edhe më krenarë.

Xhamia e Ballies shquhet për dizajnin e saj të ri, që ndërthur me mjeshtëri traditën islame me elemente moderne, duke krijuar një hapësirë unike për besimtarët dhe vizitorët. Me këtë vlerësim, Elbasani dhe Shqipëria bëhen pjesë e hartës globale të arkitekturës fetare, duke treguar se vepra të tilla nuk janë vetëm një shembull i artit dhe kulturës, por edhe një mundësi për të

promovuar më shumë turizmin dhe vlerat historike dhe kulturore të vendit. Në funksion të këtij roli, kjo xhami padyshim do të jetë pjesë e trashëgimisë moderne, dhe duhet promovuar.

5. Përfundime

Në përfundim të këtij artikulli mund të pohojmë se, është e domosdoshme të vlerësojmë të dy tipologjitë e trashëgimisë. Trashëgimia si ajo klasike dhe ajo moderne janë shumë të rëndësishme në njohjen e historisë dhe kulturës së qytetit. Elbasani është i pasur me objekte të trashëgimisë historike të para shek.XX, por edhe me objekte të shek.XX, periudhës së dytë. Kjo trashëgimi është dëshmi historike dhe më mirë se kushdo na tregon periudhën e jetuar.

Në thelb, trashëgimia moderne tregon për vrullin, përpjekjet për modernizimin e shoqërisë. Gjithashtu tregon edhe për procesin e industrializimit socialist në kushte tejet të vështira ekonomike populli ndërtoi vepra të mëdha industriale. Trashëgimia moderne jo vetëm që duhet të ruhet, por duhet të bëhet edhe e aksesueshme për publikun. Elbasani ka mjaft objekte të trashëgimisë moderne, mjafton që t'i evidentojë. Kjo është e rëndësishme veçanërisht për Elbasanin që ka pak objekte të trashëgimisë. Trashëgimia moderne do të promovojë qytetin, por gjithashtu do të ketë impakt në turizëm. Ky është Elbasani, qyteti me vlera dhe kulturë gjatë historisë së tij.

6. Bibliografia

Burime arkivore

AQSH, Fondi i Sanxhakut të Elbasanit 113/1.

AQSH, Fondi i Ministrisë së Ndërtimit, Nr. 899, Dosja nr. 894.

Literaturë historiografike

Legjislacioni për Trashëgiminë Kulturore, Nr.9048, datë 7.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore” i azhornuar, Ministria e Kulturës dhe Sporteve Drejtoria e Zhvillimit të Turizmit dhe Kulturës Kombëtare, Sektori i Kulturës Kombëtare, Neni 4, pika 1.a.

Bejko, Lorenc: Trashëgimia Moderne, leksione për studentët e nivelit master Shkencor në Trashëgimi Kulturore, Tiranë 2017.

Duka, V.: *Qytetet e Shqipërisë 1912-1924*, Shtëpia Botuese “Toena”, Tiranë 1997.

Demiri, Sh.: *Histori e shkurtër e trevës së Elbasanit*, Egnatia, Tiranë 2007.

Giusti, Maria Adriana.: *Albania, Architettura e Citta (1925-1943)*, Albania, Architecture and City, Maschinetto Publisher, Firenze 2006.

Karaiskaj, Gj.: *5000 vjet fortifikime në Shqipëri*, Shtëpia Botuese “8 Nëntori”, Tiranë 1981.

Meksi, A.: *Arkitektura e Xhamive të Shqipërisë shekujt XV-XIX*, UEGEN, Tiranë, 2007.

Tinder, G.: *Mendimi Politik*, Tiranë 1993.

Nina Smirnova, “*Historia e Shqipërisë përgjatë shekullit XX*”, Botimet “IDEART” Tiranë, 2004.

Shkodra, Z.: *Esnafet Shqiptare*, shek.XV-XX, Akademia e Shkencave e R.P.Shqipërisë, Tiranë 1973.